

Tiranë, më \_\_\_/12/2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Shërbim Evadimi të Mbetjeve Urbane për SUT” për një periudhë 24 Mujore, - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 90512000-9  
(Shërbime të transportit të mbeturinave)

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Vlera e Fondit limit është: **7,980,360** (shtatë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, **Spitali Universitar i Traumës**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. *Formularin e ofertës sipas shtojcës 1*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

**Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

**Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. **Leje të tipit III-2 B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL)** për pastrim dhe largim të mbetjeve urbane (jo të rrezikshme) ku të përfshihet qyteti i Tiranës.
- b. **Leje mjedisore** lidhur me objektin e prokurimit e lëshuar nga organet kompetente në RSH.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë kërkuar *për të vërtetuar se operatori vepron sipas legjislacionit në fuqi* dhe bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, gërma a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit (2020-2021-2022). Vlera mesatare e xhiros së duhet të jetë jo me pak se 40% te vlerës limit për të cilat ofertohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit\* të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime\* të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim\*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilën ofertohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “Kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si vërtetime/referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2.** Kandidati duhet të disponojë minimumi një makine speciale të përshtatshme për evadimin e mbetjeve urbane (kamion pirun si shembulli në foto sipas specifikimeve teknike). Kur automjetet janë në pronësi të operatorit ekonomik duhet të jenë të pajisura me dokumentacionin përkatës si më poshtë:

- Leja e Qarkullimit
- Polica e Sigurimit
- Kontrolli Teknik Vjetor

**Në rast se automjetet janë marrë me qera duhet të paraqitet :**

- Leja e Qarkullimit
- Polica e Sigurimit
- Kontrolli Teknik Vjetor
- Kontrata Noteriale e marrjes së mjetit me qera.

*Sqarim:*

*OE duhet të vetedeklarojë se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqesë në kopje origjinale ose të noterizuar nëse shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.3.** OE duhet të disponojë minimumi 3 (tre) Kosha (Konteniere për mbetje, hermetik). Vellimi i koshit (kontenieryt të mbetjeve, hermetik) duhet të jetë detyruesisht jo më i vogël se 12- 15 m<sup>3</sup>, si dhe me permasa

te peraferta 2mx4mx2m (permasat jane percaktuar si pasoje e hapsires ne dispozicion te SUT ku mund te vendosen koshat/kontenieret).

Oe duhet te disponoje dhe minimumi 8 kosha te vegjël me kapacitet minimumi 1.7 m3.

Per te vertetuar kete kriter, OE duhet te paraqese fatura tatimore blerje dhe fotografi perkatese.

*Sqarim:*

*OE duhet te vetedeklaroje se ka (sipas shtojces nr. 9) mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqesë në kopje origjinale ose të noterizuar nëse shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për të përmbushur kontratën.

**2.3.4.** Ofertuesi duhet te deklaroje qe eshte i gatshem te vendose ne dispozicion te spitalit (SUT) nje punonjes te pranishem cdo dite i cili duhet te monitoroje kryerjen e sherbimit sipas kerkesave te Ak te parashikuara ne specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Specifikimet teknike:** Sipas shtojcës “Formulari i specifikimeve teknike” publikuar në DT.

**Argumentimi:** Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar dhe në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.